

**RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9948,
DATË 07.07.2008 “PËR SHQYRTIMIN E VLEFSHMËRISË LIGJORE TË
KRIJIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE”, I
NDRYSHUAR**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË
SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projektligji është zgjatja e afateve të përfundimit të procesit të plotësimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, për territoret e ish kooperativave bujqësore, nga bashkitë, si dhe të procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga Komisionet Vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, pranë Prefektëve të çdo Qarku.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME
PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME
PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË
TJERA POLITIKE**

Ky projektligj është në përputhje dhe në zbatim të programit politik të qeverisë shqiptare për zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe në mënyrë të veçantë për konsolidimin e të drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME
PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Ligji nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, ka hyrë në fuqi më datë 15 gusht 2008, por veprimtaria ka filluar në janar 2009. Në këtë ligj janë të përfshira dy procese:

A. Procesi i plotësimit të dokumentacionit të pronësisë mbi tokën bujqësore, sipas nenit 17, pika 1/1 të ligjit nr. 9948 (për territoret e ishkooperativave bujqësore), nga Bashkitë.

Ligji ngarkon Kryetarët e Bashkive, që për rastet kur komisioni i ndarjes së tokës, e ka ndarë tokën bujqësore, por nuk ka plotësuar aktet e marrjes së tokës në pronësi, t’i plotësojnë ato, në përputhje me kriteret dhe procedurën e përcaktuar në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Komisionet Vendore të

Vlerësimi të Titujve të Pronësisë kanë vetëm rolin kontrollues, në rast të ankimeve nga individët dhe institucionet e ndryshme, ndërsa Prefekti i Qarkut mbikqyr realizimin e këtij procesi.

Nga informacioni i mbledhur nga bashkitë deri më datë 10 Tetor 2017 rezulton se janë paraqitur 2500 kërkesa nga familjet bujqësore. Për një pjesë të tyre, bashkitë kanë përfunduar plotësimin e titujve të pronësisë dhe familjet bujqësore janë pajisur me Aktin e Marrjes së Tokës Bujqësore në Pronësi (AMTP) dhe po vijnë me regjistrimin e akteve.

Ecuri të mirë e këtij procesi evidentohet në Bashkitë Himarë, Mirditë, Bulqizë, Peshkopi, Mat dhe Klos, ndërsa në disa bashki të zonës veriore të vendit si Bashkia Shkodër, Malësi e Madhe, Kukës, Has, Tropoje etj, numri i kërkesave dhe trajtimi i tyre nga bashkitë respektive është shumë i vogël. Në këto zona është prezent dukuria që familjet bujqësore janë vendosur në tokat sipas kufijve të vjetër dhe bashkitë, duke respektuar kriteret e ligjit 7051, kanë detyrimin të plotësojnë dokumentacionin e pronësisë.

Afati i plotësimit të AMTP-ve sipas ligjit përfundon në 31.12.2017.

Me qëllim që t'ju vihet në ndihmë përfituesve (familjeve bujqësore), që të formalizojnë pronësinë e tyre dhe ta disponojnë atë ligjërisht, si dhe bazuar ecurinë e deritanishme, sidomos vonesat në zonën veriore të vendit, në këtë projektligj propozohet që afati i përfundimit të këtij procesi të jetë data 31 korrik 2018.

Nëse ky afat nuk do të shtyhet, pra procesi nuk përfundon në rrugë administrative, përfituesit megjithëse kanë të drejtë t'i drejtohen organeve gjyqësore (kjo e drejtë është e parashikuar në ligj), procesi do të shtyhet edhe më tepër në kohë dhe do të shoqërohet edhe me kosto më të mëdha për përfituesit.

B. Procesi i vlerësimit të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, kryhet prej Komisioneve Vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, pranë Prefektëve të çdo Qarku dhe mbikqyret nga Komisioni Qeveritar i Tokës.

Shtyrja e afatit të plotësimit të titujve të pronësisë bën të nevojshme edhe shtyrjen e afatit të verifikimit të këtyre titujvetë lëshuar nga bashkitë. Për këtë arsye, në projektligji parashikohet që afati i përfundimit të verifikimit të titujve të pronësisë të jetë data 31 korrik 2018.

Kjo zgjatje afati do të shërbejë edhe për të trajtuar kërkesat e papërfunduara, me vendim administrativ, për të ndjekur volumin e madh të procedurës gjyqësore, për kërkesat e paraqitura në gjykatë etj.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Për këtë projektvendim është përdorur si referencë neni 78 dhe 83, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në projektligjin e paraqitur, propozohet të bëhet zgjatja e afateve deri në të ndryshohen afatet deri në 31 korrik 2018, duke bërë ndryshimet e mëposhtme:

- Në nenin 17, pika 1/1, shkronja “e”, fjalia e dytë, afati i plotësimit të AMTP-ve nga bashkitë, si dhe
- Në nenin 18, afati i verifikimit të titujve të pronësisë, nga Komisionet Vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi janë Bashkitë, Këshillat e Qarqeve, Zyrtat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale Komisioni Qeveritar i Tokës dhe Komisionet Vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, pranë Prefektëve të çdo Qarku.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është përgatitur nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe Sekretariati Teknik pranë Komisionit Qeveritar të Tokës, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji i propozuar nuk mbart efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit, përsa i takon procesit të plotësimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, për

territoret e ish kooperativave bujqësore, pasi kryhet nga administrata dhe me fondet e vetë bashkive.

Ndërsa për procesin e shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga Komisionet Vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, pranë Prefektëve të çdo Qarku, shpenzimet financiare përmblihen në kostot e këtyre strukturave shtetërore, ku përfshihen pagat e personelit dhe shpenzimet operative të parashikuara për vitin 2018.

MINISTRI

NIKO PELESHI

Konceptoi: Mimoza Shahini

Pranoi: Majlinda Bozgo

Miratoi: Irfan Tarelli

Shtjefen Zyla

Konfirmoi: Aurora Alimadhi